

AKT THEMELIMI

Shoqëria “ATLAS REAL ESTATE” sh.p.k

Sot më datë 05 / 09 / 2022, une i nënshkruari z. **Skevio Kërçuku** shtetas shqiptarë, i datelindjes 13.12.1983, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr I31213034W shpreh vullnetin tim për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “ATLAS REAL ESTATE” sh.p.k sh.p.k si më poshtë vijon:

1. FORMA LIGJORE

“ATLAS REAL ESTATE” sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

2. ORTAKET THEMELUES

Ortaku i vetem themelues i shoqërisë është Skevio Kërçuku

3. OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “ATLAS REAL ESTATE” sh.p.k është “Agjenci Imobiliare”

4. SELIA

Selia e shoqërisë tregtare “ATLAS REAL ESTATE” sh.p.k është në adresën: Rruga "Margarita Tutulani", Pallati 23, Shkalla 1, Apartamenti 14, Tiranë..

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: skevjo.k@gmail.com

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në paragrafin 1, të këtij neni mund të shkurtohet me vendim të Asamblesë së Ortakeve të shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti i shoqërisë.

6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “ATLAS REAL ESTATE” sh.p.k është 100.000 (Njëqind mijë) leke i perfaqësuar nga 1 kuote, vlera nominale e të ciles është 100.000 (Njëqind mijë) leke. Ortaket i vetem është zoterues i kuotes që perfaqëson 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë. Kuota përfaqëson të drejtën e një votë.

7. ORTAKET

Ortakët i ushtrojnë kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakeve.

8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

- Shoqëria drejtohet nga 1(nje) Administrator.
- Administratori i shoqërisë “ATLAS REAL ESTATE” sh.p.k do të jetë z. **Skevio Kërçuku**
- Administratori emërohet me Vendim të Asamblese së Ortakeve, për një periudhë jo më shumë se 5 (pese) vjet me të drejtë ripërtëritjeje.
- Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “ATLAS REAL ESTATE” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe statuti, i përket administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

9. SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

THEMELUESIT

Skevio Kërçuku

